

XHEVAT LLOSHI

MBI STUDIMIN E VEÇORIVE STILISTIKE TË SHQIPES

Zgjerimi i funksioneve shoqërore të shqipes, sidomos të shqipes së shkruar, dhe lulëzimi i letërsisë artistike në gjysmën e dytë të shekullit XIX shtruan një varg çështjesh të lidhura me gjuhën letrare kombëtare, ndërmjet tyre edhe çështjet e stilistikës, të cilat dalin në sipërfaqe dhe tërheqin vëmendjen atëhere, kur gjuha ka arritur një shkallë të caktuar zhvillimi, pasurimi e përpunimi.

Nuk del e rastit kështu, që vërejtjet stilistike për shqipen i gjejmë në fillim të shek. XX, kur përpara syve të vëzhguesit ishte një lëndë pak a shumë e gjerë dhe po lindte nevoja për vërejtje të tilla. L. Gurakuqi më 1905 paraqiste ndonjë kërkesë për gjuhën e shkencës¹.

Në këto fillime, shënimet stilistike ndeshen aty-këtu në lidhje me problemet e gjuhës kombëtare e sidomos të lidhura me letërsinë artistike. Për mjaft kohë anët gjuhësore janë përfshirë në kornizën e stilistikës letrare, duke e kuptuar atë si artin e stilit, si artin për të shkruar bukur, për të përdorur mjetet shprehëse të gjuhës. Më 1906 L. Gurakuqi për stilistikën poetike boton një vepër më vete «Vargë-nimi n'gjuhë shqype».

Përpjekjet për të futur në stilistikën e shqipes teorinë e «tre stileve» zënë fill që te vepra e A. Zanonit, i cili jep edhe një përkufizim të stilit². Këto stile autori i quan: stili i madhnueshëm, stili i thjeshtë dhe stili i përgjyhtë. Në tekstet e mëvonshme të J. Rrotës³ dhe të A. Xhuvanit e K. Cipos⁴, përkufizimet e stilit plotësohen, teoria e tre stileve pajiset me gjinitë përkatëse dhe përcaktohet terminologjia: stili i thjeshtë (a i ulët), stili i mesëm, stili i lartë.

Konceptet stilistike, që mbizotëronin në këto vepra dhe në ndonjë shkrim të rrallë të kohës, nuk niseshin gjithnjë nga lënda e shqipes

1) «Shkencat t'gjitha, e ma tepër matematika e filozofia, kërkojnë një shtyll t'posaçëm: gjuha do t'jenë e lehtë, skajet t'zgjedhuna e qi t'i përkasin mennimit qi donat me shqyptue, përmbledhja e dliër e e rrjedhtë, pa përbartje e pa stërhollime retoriket». L. Gruda, *Gjuha e shkencësve*, «Albania», 1905, nr. 7, f. 158.

2) A. Zanonit, *Prisi n'lamë t'leteratyres, Parime mbarë letratyret*, botuar në fillim në revistën reaksionare katolike «Elçija e zemrës Jezu Krishtit», 1911 në disa muaj, vijimi më 1913, nr. XII dhjetor; ribotimi i përmirësuar *Prisi në lamë të letratyres*, Shkodër, 1920, si tekst mësimor. «Stili asht dora qi merr biseda a shkrimi prej cilsis t'idheve e t'akteve; shkurt, prej mëndyret si shkrintari i shef e i ndin sendet: kështu pikë së parit; mandej prej të zgjedhunit e prej rreshtimit të fjalve, e prej të lidhunit të tyne» f. 71.

3) J. Rrota, *Letratyra shqipe për shkolla të mjesme*, Shkodër, 1925, botimi i dytë 1934.

4) A. Xhuvani — K. Cipo, *Fillime të stilistikës e të letërsisë së përgjithshme*, T. 1930.

dhe e letërsisë shqipe. E meta themelore ishte, se ato koncepte qenë përpunuar kryesisht për letërsinë klasike dhe të klasicizmit, mbështetshin në analizën logjiciste të materialit dhe prandaj një stilistikë e tillë ishte e paaftë për të trajtuar problemet e letërsisë shqipe demokratike, përparimtare e me drejtim realist. I mbetej kështu më tepër trajtimi formal i metrikës dhe i gjinive letrare, ose jepte udhëzime mbi mënyrën e paraqitjes së mendimeve bukur e rrjedhshëm nga ana logjike.

Megjithatë, qysh në këto vepra gjetën vend disa elementë me rëndësi për stilistikën. Qoftë edhe pa u thelluar, u vunë në dukje dy anët kryesore të çdo stili: ana subjektive, pasqyrimi i veçorive individuale të autorit, dhe ana objektive, e përgjithshmja, që varet nga lënda, nga përmbajtja dhe sfera e përdorimit të mjeteve të gjuhës⁵. Gjithashtu u prekën edhe roli i *zgjedhjes* dhe i *mënyrës së kombinimit*, të lidhjes dhe të organizimit të elementëve, dukuri që të dyja njësorj të rëndësishme për karakterizimin e stilit.

Në tërësinë e vet, periudha para çlirimit mbyllet me rezultate të pakta në lëmin e stilistikës.

Puna e 25 vjetve pas çlirimit mund të çmohet drejt, kur të shihet e lidhur me detyrat e mëdha, që shtruan e zgjidhën letërsia dhe gjuhësia në këtë periudhë jo vetëm të kërkimeve e të studimeve të gjithanshme e të thelluara, por edhe të daljes në dritë të pasurive e të vlerave të reja letrare e gjuhësore.

Në lëmin e stilistikës letrare, megjithëse nuk është përpunuar ende një teori e plotë e gjuhës së letërsisë artistike, e ligjërimit poetik, përsëri është grumbulluar një material i vlefshëm në artikujt e punimet, në botimet e tekstet, në diskutimet e studimet. Me këtë janë pregtitur kushte për përgjithësime, për formulimin e parimeve shkencore, mbi të cilat të mbështetet studimi i veçorive stilistike të letërsisë së realizmit socialist, që krahas vlerës ideore, e ka pasuruar artin tonë me një larmi mjetesh e stilesh; mbi këto përgjithësime mund të mbështetet edhe shqyrtimi i veçorive individuale të secilit autor.

Stilistika letrare i kthehet formës artistike të veprave dhe gjuhën e sheh si element themelor, si brumin e saj, i zbërthen funksionin estetik në krijimtari, shqyrton mjetet shprehëse e figurative etj., duke i parë veçoritë stilistike të lidhura si me individualitetin e shkrimtarit, edhe me përmbajtjen, me rrymën letrare, me gjininë etj. Mund të vihet një kufi i përfaqësues i saj me stilistikën gjuhësore dhe ne nuk do ta prekim më tej, duke lënë mënjanë njëkohësisht edhe problemet e gjuhës në letërsinë artistike.

Stilistika gjuhësore vë në qendër të studimit stilet gjuhësore, shtresimin stilistik të mjeteve në gjuhën letrare, mënyrën e zgjedhjes dhe të përdorimit në ligjërimit të mjeteve të shprehjes që ka gjuha, në vartësi nga përmbajtja dhe qëllimi i asaj që thuhet, nga sfera dhe kushtet e komunikimit.

Zhvillimi i gjuhës shqipe në rrethanat krejt të reja shoqëroro-historike, që u krijuan pas çlirimit, si dhe ngritja e nivelit shkencor të gjuhësisë, sollën pasurimin e trajtimit të shqipes edhe me një vështrim

5) A. Xhuvani — K. Cipo, *vep. cit.*, f. 66 shkruajnë: «Pas përkufizimit të sipërm, çdo stil ka një anë subjektive e një tjetër objektive.» J. Rrota, *vep. cit.* f. 23. shprehet kështu: «Sejçili njeri e ka atë stilin e vet, qi trajtohet mbas natyrës së tij, mbas shkallës s'arësimit e deri mbas moshës së tij; por edhe secila farë e hartimit e lypë ata stilin e vet të posaçëm».

tjetër — me vështrimin stilistik. Vetëm pas çlirimit zuri vend koncepti *gjuhësor* mbi stilin.

Përpjekjet e fillimit, për të dalluar në gjuhën e sotme shtresa të ndryshme, i gjejmë te parathënia e «Gramatikës shqipe» të K. Cipo⁶. Aty jepet një ndarje, e cila do të përshkojë më vonë ku më shumë e ku më pak edhe punime të tjera. Kjo është ndarja në *gjuhë të folur* dhe *gjuhë të shkruar*. Shtresimi çohet edhe më tej: gjuha e shkruar ndahet në gjuhën *letrare* (është fjala për gjuhën e letërsisë artistike) dhe në gjuhën *shkencore*, «e cila rreh të shprehë një mendim me qartësi e përpikësi të madhe». Kjo është një përpjekje për dallimin e stileve funksionale. Edhe në gjuhën e folur aty veçohet «gjuha që përdorim me ata që kanë një farë diturie, që është shqipja e zhveshur disi nga depërtimet dialektore», pra gjuha e folur letrare dhe gjuha «popullore, që përdoret nga masat e gjëra të popullit. Është një shqipe jo dhe aq e punuar.» — me terminologjinë e sotme ai që quhet ligjërimi bisedor.

Kjo parathënie meriton vëmendje, sepse këto nuk janë më pohime të përgjithshme, por autori është përpjekur t'i zbatojë në trajtimin e lëndës konkrete, si p.sh. për mënyrat e foljeve. Po këtë vazhde e ndjek autori edhe në «Sintaksën»⁷.

Ndarja në gjuhë të folur dhe gjuhë të shkruar është marrë parasysh në dy përmbledhjet kryesore për parashtesat dhe prapashtesat e shqipes⁸, duke përdorur termin «gjuhë popullore»⁹, porse të dyja anët janë vështruar të lidhura ngushtë dhe jo si të kundërvëna ose të shkëputura.

Duke qenë se stilistika gjuhësore i sheh mjetet e gjuhës nga ana funksionale e ekspresive, ajo ecën përpara e mbështetur në rezultatet e fonetikës dhe të gramatikës, të leksikologjisë e të fjalëformimit. Në artikujt e punimet e ndryshme dhe në tekstet mësimore ka një varg konstatimesh, vëzhgimesh e trajtimesh, të cilat së bashku po krijojnë atë bazë, pa të cilën është i pamundur përgjithësimi i mëtejshëm stilistik.

*
* * *

1. Në fushën e fonetikës, janë dalluar dy ndarje themelore stilistike: stili i plotë dhe stili i bisedimit¹⁰. Për karakterizimin e shqiptimit bisedor nuk duhet harruar edhe një veçori e fonetikës sintaktike të shqipes: «në fjalinë e shqipes në të folur fjalët nuk ndahen njëra nga tjetra, po shqipja, ashtu si frengjishtja, *lidh*, d.m.th., i shqipton

6) K. Cipo, *Gramatika shqipe*, T. 1949.

7) K. Cipo, *Sintaksa*, T. 1952.

8) A. Xhuvani — E. Çabej, *Parashtesat e gjuhës shqipe*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1956, nr. 4, f. 66-103; *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, T. 1962.

9) Termi *gjuhë popullore* nuk mund të marrë një përmbajtje të përcaktuar stilistike në gjendjen e sotme, pasi në të do të përfshiheshin gjuha e folur letrare dhe nëndarjet e tjera, bashkë me dialektet. Prandaj kundërvënia *gjuhë e shkruar — gjuhë popullore*, që ndeshet edhe në punime të tjera, në të vërtetë mund të shërbejë për trajtimin historik, lidhur me etapat e përpunimit të gjuhës letrare. P.sh. fjala *pakujdesi* e krijuar në «gjuhën popullore», sot është element i mbarë shqipes së shkruar e të folur.

10) A. Dodi. *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, dispensë, T. 1966, f. 17.

fjalët në një varg të pandarë»¹¹. Duke shtuar këtu edhe rolin e theksit në fjalë e në fjali, mund të shpjegohen edhe reduktimet e tingujve e të rrokjeve. Stili i plotë i përket gjuhës së shkruar dhe që në këtë nivel spikat prirja themelore e saj për të pëlqyer trajtat e plota.

Shkalla e ngulitjes së normave të drejtshqiptimit dhe mungesa e studimeve të veçanta nuk na lejojnë tani për tani t'i kapërcejmë kufijtë e këtij konstatimi të përgjithshëm.

2. Në fushën e morfologjisë, siç u përmend më lart, disa vërejtje për pjesët e ligjëratisë e gjejmë që te veprat e K. Cipos.

Në disa punime të fundit ka vëzhgime sidomos për foljet. A. Dodi ka treguar p.sh. se përdorimi i së kryerës në vend të së kryerës së thjeshtë është karakteristik për gjuhën e folur, megjithëse nuk mungon dhe në gjuhën letrare¹², edhe e kryera e mbipërbërë asaj i përket, ndërsa gjuha e shkruar e ka nxjerrë në periferi. Për foljet aspektive të fillimit të veprimit janë karakteristike të gjuhës së folur konstruktet me bashkërenditje, ndërsa konstruktet me lidhoren janë të gjuhës së shkruar¹³. Është vënë re edhe ndryshimi i reksionit të foljeve midis gjuhës së folur e gjuhës së shkruar¹⁴. Për shfrytëzimin stilistik të pjesëve të tjera të ligjëratisë ka disa konstatime të pjesshme¹⁵.

Gjatë hartimit të gramatikës së gjuhës së sotme shqipe del si një detyrë e re të jepet një kuadër i plotë i këtyre veçorive për secilën pjesë të ligjëratisë. Megjithatë edhe stilistikës i mbetet një pjesë në këtë detyrë: përgjithësimi i anëve në dritën e një sistemi stilistik. Të marrim për shembull një pjesë nga një artikull studimi i zakonshëm, jo tepër special:

«Një tjetër hallkë e boshtit ideologjik do të ishte vështrimi kritik i kufizimeve ideo-estetike të shkrimtarëve si pasojë e kompromisit dhe e lëshimeve, që ideologjia e borgjezisë i bën ideologjisë së vjetër feudo-klerikale. Këto lëshime, që vërehen në luftën klasore midis borgjezisë dhe feodalizmit, kanë shkaqe të ndryshme, midis të cilëve kryesori është se, në fakt këto dy klasa janë të ngjashme me njëra-tjetrën, ato që të dyja në esencë janë shtypëse dhe shfrytëzonzëse. Edhe morali i tyre në esencë është i njëjtë, me ndonjë ndryshim të vogël të karakterit historik. Kështu diskriminimi midis burrit dhe gruas, diskriminimi racial, shtypja, shfrytëzimi, gënjeshttra, vrasja, të gjitha këto janë norma si të moralit feodal, ashtu edhe të atij borgjez... Një element tjetër që duhet patur parasysh për boshtin ideologjik në studimin e letërsisë është dhe momenti subjektiv, që ushtron ndikim të fortë në veprën e shkrimtarit»¹⁶.

Bie menjëherë në sy numri i madh i emrave në krahasim me foljet. Kjo vjen për shkak të nevojës së prozës shkencore për terma, por lidhet edhe me parapëlqimin në përgjithësi i ndërtimeve me emra në vend të foljes («duhet patur parasysh në studimin e letërsisë» në vend

11) E. Çabej, *Fonetika historike e shqipes*, dispensë, T. 1960, f. 93.

12) A. Dodi, *Për vlerën e së kryerës së dëftores në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1968, nr. 1, f. 68.

13) M. Totoni, *Konstrukte me folje aspektive të fillimit të veprimit në gjuhën shqipe*, «Studime filologjike», 1968, nr. 1, f. 88.

14) A. Dhrimo, *Një vështrim mbi foljet me më se një reksion në shqipen e sotme letrare*, «Studime filologjike», 1965, nr. 2, f. 150.

15) Janë botuar në gazetën «Drita» gjatë 1967-1968 disa shënime të shkurtra për emrat, mbiemrat, ndajfoljet, foljet.

të «kur *studjojmë* letërsinë»), pëlqehet ndërtimi folje + emër në vend të foljes së thjeshtë (*ushtron ndikim — ndikon*); zëvendësimi i foljeve me emra rrit medoemos numrin e emrave të veprimit (*vështrim, kufizime, lëshime, ndryshime, diskriminim etj.*). Nga ky parapëlqim vjen denduria e madhe e rasës gjindore dhe vargu i disa gjindoreve (vështrimi i kufizimeve të shkrimtarëve). Përdoren gjithashtu emra me parafjalë të tipit *në fakt, në esencë etj.*

Përsa u përket foljeve, meqë në studimet jepen pohime për të vërtetat shkencore, për njohuritë, sendet, fenomenet, parimet etj., mbizotërojnë foljet e qenjes, e gjendjes ose të ndryshimit të gjendjes; në fragment mbizotëron folja *jam*. Foljet e tjera dalin më shpesh në trajtën pësore, për të shmangur karakterin personal të paraqitjes së mendimit, për ta dhënë atë si një të vërtetë objektive («këto lëshime që vërehen» në vend të «këto lëshime që vërehen»); këtij qëllimi i shërbejnë edhe ndërtimet me *duhet* (duhet patur parasysh). Pasojë e drejtpërdrejtë e kësaj është pakësimi i kundrinave të drejta, d.m.th. i emrave në rasën kallëzore, dhe shtimi i përdorimit të rasave me parafjalë, pra dhe shtimi i parafjalëve. Po të sillnim shembuj të tjerë, do të dilte e qartë edhe lidhja midis zvogëlimit të numrit të foljeve dhe shtimit të mbiemrave të ardhur nga pjesoret, lidhja midis shtimit të emrave dhe shtimit të përemrave të ndryshëm, për të shmangur keqkuptimet. Po kështu shpjegohet përdorimi i mbiemrave relativë për të mënjeluar vargun e gjatë e të rënduar me emra, sidomos kur emri i parë është në rasë të zhdrejtë (pra zëvendësimi i togjeve emër + emër me lidhje emër + mbiemër). Nga ana e vet, ngarkimi i një emri me disa mbiemra shpie në lindjen e mbiemrave të përngjitur, të tipit: *ideo-estetik, feudo-klerikal*. Një tablo të kundërt do të kishim po t'i merrnim këto lidhje e t'i gjurmonim në një fragment nga gjuha e gjallë e folur.

Mund të sillnim edhe mjaft veçori të tjera të përdorimit të emrave, mbiemrave, foljeve, ndajfoljeve etj. në stilin shkencor, por besojmë se tashmë del i qartë mendimi kryesor: përdorimi stilistik i secilës pjesë të ligjëratës kushtëzohet nga kërkesat e stilit përkatës dhe është në lidhje të ngushtë me përdorimin e pjesëve të tjera.

Edhe veçoritë morfologjike marrin kështu një karakter sistemor në secilin stil dhe përdorimi i të njëjtit mjet ose i të njëjtës formë morfologjike në stile të ndryshme varet nga sistemi në secilin stil, varet nga vendi që zë në stilin përkatës, ku merr edhe ngjyrimin.

3. Në fushën e sintaksës, studimi i disa tipave të periudhave me fjali të varura ka ndriçuar anë të ndryshme të ndërtimeve në funksion të kërkesave të stileve. Kemi parasysh sidomos një varg punimesh të S. Floqit¹⁷ në këtë fushë dhe ndonjë punim tjetër¹⁸.

Për gjuhën e folur, midis të tjerash, është vënë në dukje përdorimi i shpeshtë i togut të lidhëzave se... pa në fjalitë e varura shkakore

16) M. Xhaxhiu, *Probleme të boshtit ideologjik marksist-leninist në studimin e letërsisë së huaj*, «Nëndori», 1969, nr. 1, f. 60-61.

17) S. Floqi, *Periudha me fjali të varur rrjedhimore në shqipen e sotme*, «Studime filologjike», 1965, nr. 2, f. 55-99; *Periudha me fjali të varur kryefjalore në shqipen e sotme*, I, «Studime filologjike», 1965, nr. 3, f. 3-39; II «Studime filologjike», 1965, nr. 4, f. 3-37; *Periudha me fjali të varur shkakore*, I, «Studime filologjike», 1966, nr. 2, f. 3-41; II «Studime filologjike», 1966, nr. 3, f. 3-48; III «Studime filologjike», 1967, nr. 1, f. 13-33.

18) S. Mansaku, *Rreth formave të shprehjes së raporteve kushtore në shqipen e sotme letrare*, «Studime filologjike», 1969, nr. 3, f. 153-166.

dhe i tipit të veçantë me konstrakte tautologjike e jotautologjike në periudhat me lidhëza kushtore, që në protazë dhe apodozë kanë si kallëzues të njëjtën folje; përhapja e gjërë (edhe në folklor) e fjalive kryesore me përemrin *ç'* dhe foljen *kam* në periudhën me fjali të varur rrjedhimore, mbizotërimi i lidhëzës *që* në dialog për fjalitë e varura rrjedhimore etj.

Për gjuhën e shkruar është theksuar se ka prirje të zgjerohet rrethin e kallëzuesve (foljeve e shprehjeve foljore), që kërkojnë një fjali të varur kryefjalore; janë të kësaj gjuhe konstruktet e fjalive rrjedhimore me korelate ndajfoljet *mjaft*, *tepër* dhe me korelatin *i tillë*, si dhe ndërtimet e periudhave me fjali kryefjalore me foljen *jam* plus një emër foljor me parafjalën *për*; në periudhat me fjali të varura shkakore gjuhës së shkruar i përkasin shprehjet lidhëzore *me qënë se (që)*, *nga shkak se (që)*, *për shkak se*, *për arsye se*, përdorimi i lidhëzës *mbasi* në vend të *se*, *sepse*, kur fjalia e varur shkakore vjen pas kryesores etj.

Me vlerë janë vërejtjet për ngjyrimet stilistike të konstrakteve jo vetëm në këtë ndarje të parë: gjuhë e shkruar — gjuhë e folur, por edhe në stilet e gjuhës së shkruar.

Për stilin e publicistikës dhe krahas tij për stilin shkencor, janë vërejtur këto përdorime: për fjalitë kushtore, kallëzuesit prej foljesh e shprehjesh foljore si *mendoj*, *shikoj*, *vërej*, *marr në vështrim* etj.; periudha kushtore me fjali drejtuese mohuese dhe fjali të varur me pjesoren të mohuar. Për fjalitë shkakore: përhapja e lidhëzave *për shkak se*, *për arsye se*, *me qënë se*; togu i lidhëzave *sepse... prandaj*. Për fjalitë rrjedhimore: përdorimi i ndërtimeve me lidhëzën *kështu që* dhe në *mënyrë që*. Periudhat me fjali të varur kryefjalore gjithashtu u përkasin kryesisht veprave të stilit publicistik-shkencor, në funksionin e kallëzuesit njëvetor në fjalinë kryesore dalin foljet *duhet*, *kërkohet*, *lejohet*, *lypset* etj.

Në stilin juridik-administrativ periudhat me fjali të varura kryefjalore shërbejnë për kodifikimet, sidomos ato që shprehin marrëdhënjet kusht-pasojë; ato janë më të shtjelluara, me gjymtyrë homogjene dhe me fjali të bashkërenditura; tipikë janë kallëzuesit me foljen *jam* plus emrat *ligj*, *rregull*. Në fragmentet e stilit juridik (edhe shkencor) me karakter arësytues fjalia shkakore del me shprehjet lidhëzore *duke qënë se (që)*; në këtë stil është ngulitur shprehja *duke marrë parasysh se* dhe nga gjuha e shkresave zyrtare kanë dalë shprehje si *për arsye se* etj.

Edhe në nivelin e sintaksës, stilistikës i mbetet të bëjë përgjithësimin e të dhënave dhe vendosjen e lidhjeve midis tyre, duke i parë në funksion të kërkesave të secilit stil, të përmbajtjes së tij dhe sistemit të përpunuar në të.

Në sintaksë p.sh. vërehet qartë një dallim në vijë të gjerë midis gjuhës së folur e gjuhës së shkruar: e para pëlqen më tepër ndërtimet me bashkërenditje, me lidhëza të thjeshta, e dyta pëlqen ndërtimet, periudhat me nënrenditje, të ngarkuara me lidhëza të përbëra. Togjet e lidhëzave të gjuhës së shkruar përmbajnë fjalë emërtuese: folje dhe emra. Po të kujtojmë veçorinë morfologjike të mbizotërimit të foljeve të qenjes, të gjendjes, që u përmend më lart, atëherë shpjegohet edhe përse mbizotërojnë këto folje në togjet lidhëzore, krahas disa emrave abstraktë të përgjithshëm. Kështu tiparet sintaktike janë në lidhje të ngushtë me tiparet morfologjike të se-

cilit stil. Në rast se do të përfshijmë këtu edhe veçorinë e prekur për fonetikën, atëhere do të dalim përpara një përgjithësimi të njohur për të tre nivelet: gjuha e shkruar ka prirjen për të përdorur trajtat më të plota, më të shtjelluara, më të zgjeruara, ndërsa gjuha e folur pëlqen mjetet më të shkurtra, më të cingura, më të thjeshta.

Këtë pohim e provon mirë ripunimi, që i ka bërë F. Noli «Historisë së Skënderbeut», ripunim që është një dëshmi e rrugës së formimit të stilit shkencor. Në botimin e dytë autori ka zëvendësuar trajtat më të shkurtra të një mjeti gjuhësor me trajta më të zgjeruara, më të plota. P.sh. *ish* e zëvendëson me *ishte*, *s'* me *nuk*, *ca* me *disa*, *veç* me *veçse*, *e*, *dhe* i zëvendëson me *edhe* madje duke e tepëruar nganjëherë; krahasoni edhe shembujt: ishte *pas* përshkrimit të Tivarasit (bot. I) — ishte *sipas* përshkrimit të Antivarios (bot. II); si ushtarët, si oficerët (bot. I) — si ushtarët, *ashtu edhe* oficerët (bot. II) etj.

Duke patur në dorë përgjithësimet të tilla, mund të gjykojmë më mirë edhe për rastet e veçanta. Kështu p.sh. për lidhëzën *me qenë se* S. Floqi¹⁹ vëren se i përket gjuhës së shkruar. Mirëpo shembujt e sjellë aty, si «me qenë se bën ftohët, më mbajtën të rri në dhomën e tyre», ose «me qenë se nuk mund t'i ngjante Sofikës nga ngjyra e flokëve» etj. në të vërtetë e kanë të përdorur jo drejt nga ana stilistike lidhëzën, nuk kishte përse kjo përmbajtje të jepej me një lidhëzë të tillë librare. Një varg shembujsh të tjerë, të cituar për të vërtetuar përdorimet e lidhëzës *me qenë se*, janë nga vepra humoristike dhe autorët (Q. Buxheli, M. Kallamata, D. Bubani), që e kanë ndjerë ngjyrimin libror të lidhëzës dhe të ndërtimeve me të, e kanë përdorur në kundërshtim me kërkesat e përmbajtjes, pikërisht për të nxjerrë humorin nga kjo mospërputhje e konstruktive librare me përmbajtjen nga jeta e gjallë e përditshme. Kjo mospërputhje, e përdorur si mjet stilistik, krijon humorin në shembujt si: «Meqënë se kësaj here Dita e gënjeshtrove bie në një ditë me atë të karnavaleve, do ishte mirë për ju, si gjithë të tjerët, të vinit në klub me maskë», ose «Me qenë se puna e sotme nuk duhet lënë për nesër, doktor Troka lë të gjitha punët që i kanë mbetur nga dita e djeshme dhe, si ve gjyslykët midis hundës, fillon të lexojë gazetën me një ton prekës» (citata nga Q. Buxheli). Të vihet re sidomos se si është «përpunuar», për t'i dhënë trajtën librare sipas gjithë kërkesave të stilit, shprehja e njohur proverbiale «punën e sotme mos e lër për nesër».

E njëjta gjë vërehet edhe në raste të tjera. Në «Sintaksën e shkollave pedagogjike»²⁰ për shembull, për të ilustruar fjalitë shkakore me shprehjet lidhëse, jepen: «Me qenë se ra shi, të dielën s'dola fare nga shtëpia» dhe «Duke qenë se s'erdhe ti, edhe ne mbetëm pa shkuar te Agroni». Në të dy shembujt lidhëza dhe ndërtimi nuk përputhen me përmbajtjen, nuk janë zgjedhur në përshtatje me sferën së cilës i përket përmbajtja. Më poshtë po aty vërehet mundësia e zëvendësimit të fjalive shkakore me një plotës shkaku, p.sh. «Prej borës së madhe ishte prerë rruga; Mbasi kishte rënë borë e madhe, ishte prerë rruga». Kjo vërejtje interesante meritonte interpretimin

19) S. Floqi, *Periudha me fjali të varur shkakore* II, «Studime filologjike», 1966, nr. 3, f. 24.

20) M. Domi, *Gramatika e gjuhës shqipe. Sintaksë për shkollat pedagogjike*, T. 1966, f. 141.

stilistik: kemi të njëjtën përmbajtje, të shprehur me mjete të ndryshme me dallime stili. Ky është thelbi i çdo stili: zgjedhja e mjeteve nga thesari i gjuhës në përshtatje me qëllimin, me përmbajtjen, me kërkesat e përpunuara historikisht për secilën sferë. Në shembullin e sjellë, pjesa «ishte prerë rruga» kërkonte gjithashtu karakterizimin stilistik leksikor dhe periudha do të dilte e plotë p.sh. në një artikull publicistik ose në një raport zyrtar: «Mbasi kishte rënë dëborë e madhe, ishte ndërprerë qarkullimi në rrugë».

U ndalëm në këtë çështje, për arsye se ndër dy tiparet themelore të çdo stili: *zgjedhja* dhe *kombinimi* i mjeteve, sintaksa zë një nga vendet kryesore. Në të vërtetë, *leksiku* dhe *sintaksa* janë dy anët më karakterizuese për çdo stil dhe nuk është e rastit, që pikërisht ato kanë gjetur trajtim më të gjërë deri më sot.

Nga vërejtjet e derisotme në fonetikë dhe në gramatikë mund të lindë përshtypja, se ka një dallim të madh midis gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur. Kjo përshtypje vjen nga që janë nxjerrë në pah veçoritë që shquhen më mirë, që bien më tepër në sy. Në të vërtetë gjendja është tjetër. E para, kjo ndarje, e mbështetur në kushtet e komunikimit, ndikon mbi veçoritë e stileve, por dallohet prej tyre. E dyta, shtresimi stilistik nënkupton një ndarje tjetër. P.sh. në gjuhën e folur hyjnë gjuha letrare e folur dhe dialektet, që nuk janë nëndarje stilistike, por edhe ligjërimi bisedor e ligjërimi i thjeshtë, që janë nëndarje stilistike. E treta, edhe historikisht, edhe sot për shqipen nuk vihet re një hendek midis gjuhës së shkruar e të folur, siç mund të jetë në ndonjë gjuhë tjetër²¹. Prandaj zbulimi i veçorive të tjera stilistike të mjeteve fonetike e gramatikore të shqipes së sotme do të dëshmojë jo për një kundërvënje e polarizim të theksuar të tyre, por për një përdorim të hollë e me mjeshtëri të mundësive që na jep shoqëria, kur ja arrijmë t'i japim mendimet me forcë shprehëse, me nuancime, me zhdërvjelltësi, në përputhje harmonike me synimet dhe përmbajtjen e tyre.

4. Në fushën e leksikut, shënimet e para stilistike në një fjalor i gjejmë te «Fjalori i shkurtër shqip-rusisht», botuar më 1950. Megjithëse termat nuk janë të përpiktë dhe brenda në fjalor ka të meta në vënien e tyre, përsëri kjo ishte një gjë e re për leksikografinë shqipe, pasi para çlirimit as ishte shtruar si çështje, ndonëse qenë botuar mjaft fjalorë e qenë zhvilluar diskutime për ta.

Mungesa e studimeve paraprake për shtresimin stilistik të leksikut është ndjerë në «Fjalorin e gjuhës shqipe» të vitit 1954. Autorët janë përpjekur që lënda e fjalorit të përfshinte fjalë si të gjuhës së folur, të letërsisë artistike, të fushave të ndryshme të shkencës dhe krahinore. Në fjalor ka shënime për termat shkencorë dhe rallë për ndonjë fjalë të vjetëruar. Për këtë arsye, në kritikën që ju bë fjalorit, u vu në dukje si e metë mungesa e trajtimit stilistik të fjalëve²².

Ndryshe nga gramatika, e cila siç u theksua, ka prekur anë të ndryshme të përdorimit stilistik të mjeteve, por pa dhënë formulime

21) «Në frengjisht ose në greqisht, për shembull, diferencat ndërmjet gjuhës së shkruar dhe gjuhës së folur janë të konsiderueshme; në gjuhë të tjera, për shembull në rumanisht, këto divergjenca megjithëse nuk janë aq të thella, përsëri janë mjaft të dallueshme». B. Cazacu, *Langue parlée langue écrite, style oral*, «Revue roumaine de linguistique», Tome IX, 1964, nr. 4, f. 397.

22) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit të fjalorit normativ të shqipes së sotme*, «Buletin për shkencat shoqërore», 1955, nr. 4, f. 48.

përgjithësuere, leksikologjia është nisur nga konceptimi i përgjithshëm stilistik i shtresave të leksikut dhe në bazë të tij ka vështruar ngjyrimin e fjalëve në veçanti. Që më 1955 A. Kostallari, lidhur me kërkesat e karakterizimit stilistik të fjalëve në fjalor, përcaktonte si detyrë «Studimin e stileve të gjuhës sonë letrare, e cila është e lidhur ngushtë me detyrën e madhe të hartimit të fjalorit normativ»²³.

Përpyekje konkrete për të bërë shtresimin stilistik²⁴ të një grupi leksikor gjejmë në punimin e po këtij autori për kompozitat ekzocentrike²⁵. Aty dallohen tri shtresa kryesore të leksikut: leksiku asnjans ose ndërstilor, leksiku i librave ose libror dhe leksiku i gjuhës së folur. Në leksikun e gjuhës së folur veçohen edhe fjalët me nuanca të theksuara ekspresive, që i përkasin gjuhës së folur të lirë ose të folurit të thjeshtë. Ndërsa në leksikun libror veçohet leksiku poetik tradicional dhe terminologjik, që përfshin emrat e përbërë abstraktë. Të gjitha këto ndarje ilustrohen me një shumicë shembujsh.

Vlera e këtyre përpjekjeve duhet parë jo thjesht në një klasifikim më të hollësishëm dhe konkret të një grupi fjalësh, por në zbatimin e vështrimit stilistik për shpjegimin e formimit të fjalëve. Ky vështrim është ndjekur edhe në punimet e mëvonshme të autorit²⁶; kështu p.sh. është përcaktuar që kompozitat dëshirore e urdhërore i përkasin gjuhës së folur e sidomos sferës së thjeshtligjërimit.

Prirja në leksikologjinë tonë për përgjithësimet stilistike ka bërë të mundur, që në «Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»²⁷ të arrihet vlerësimi stilistik tërësor i leksikut të shqipes së sotme. Pa u kaluar anash vështirësi që paraqet karakteristika e fjalëve në fjalorin e ardhshëm, aty janë përcaktuar shtresat e leksikut, që do të marrin shënime përkatëse stilistike, duke dhënë edhe tiparet dalluese të shtresave. Në këtë mënyrë hartuesit e fjalorit që po përgatitet kanë në dorë si të thuash tabelën e ngjyrave, për të përcaktuar ngjyrimin stilistik të secilës fjalë. Me rëndësi është edhe formulimi i pikëpamjes, se «shumica dërmuese e fjalëve të gjuhës sonë të sotme letrare përdoren në të gjitha stilet e ligjëratës, pra janë fjalë stilistikisht neutrale (asnjansë)»²⁸.

Siç dihet, leksikologjia historike e shqipes ka studjuar me imtësi prejardhjen e fjalëve të huazuara dhe janë klasifikuar prej saj fjalët sipas burimit të huazimit. Kjo ka ndikuar, që të ecë përpara edhe vështrimi stilistik i grupeve të fjalëve sipas burimit.

Në këtë drejtim, më tepër se çdo grup tjetër kanë tërhequr vëmendjen huazimet orientale, për të cilat edhe objektivisht ngjyrimi stilistik në gjuhë është më i qartë. Me sa duket, A. Kostallari e ka theksuar për herë të parë ndryshimin që kanë pësuar turqizmat si

23) A. Kostallari, *po aty*, f. 49.

24) Në dispensën e J. Stefit, *Leksikologjia shqipe*, 1961, f. 61-64, shtrohet nevoja e dallimit të stileve gjuhësore, por shtresimi stilistik i leksikut të shqipes nuk është bërë.

25) A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, «BUSHT, Seria shkenc. shoq.» 1962, nr. 3, f. 3-45.

26) A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, «Studime filologjike», 1963, nr. 4, f. 23-64.

27) A. Kostallari, *Parimet themelore për hartimin e «Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe»*, «Studime filologjike», 1963, nr. 3, f. 78.

28) *Po aty*, f. 109.

shtresë në tërësi nga pikëpamja stilistike²⁹. Një përpjekje të mëvonshme për të studjuar funksionin stilistik të turqizmeve në shqipen e ka bërë A. V. Desnickaja³⁰. Janë përcaktuar prej autores sferat e përdorimit të sotëm të turqizmeve, duke u ndalur sidomos në përdorimin me mjeshtëri në vjershat e F. Nolit. Megjithatë në artikull ka një mendim themelor, sipas të cilit shtresa orientale e leksikut të sotëm të shqipes ka një pasuri të madhe mundësish stilistike dhe prandaj meritojnë të qortohen autorët tanë të sotëm, që nuk kërkojnë mjete të reja shprehëse në leksikun oriental.

Një kërkesë themelore për përcaktimin e ngjyrimet stilistik të mjeteve në gjuhë (dhe përkatësisht të funksionit të tyre) është ballafaqimi i tyre me mjetet asnjëse ose të një shtrese tjetër stilistike, pra vendosja e opozicioneve stilistike. Këto opozicione nuk janë gjetur gjithnjë saktë nga autorja, krahas disa pasaktësive të tjera të vogla³¹.

Një arsye tjetër e mendimit jo të drejtë mbi funksionet e «gjithanshme» stilistike të turqizmeve në shqipen është se ligjërimi i folur popullor është shkëputur nga ndikimi i gjuhës letrare, ndërsa për gjuhën letrare është theksuar vetëm purizmi, duke e shkëputur gjithashtu nga marrëdhënjet e gjalla me ligjërimin e folur dhe nga kushtet konkrete historike shoqërore. Le t'i shohim pak më afër këto anë, pasi marrin vlerë për problemet stilistike të leksikut në përgjithësi.

Që nga autorët e vjetër e sidomos që nga Rilindja, qëndrimi i lavruesve të gjuhës ka qenë i qartë: të mënjanohej turqizmat, pasi ato lidhen me gjuhën e pushtuesit të urryer, por njëkohësisht të pasurohet gjuha e shkrimit nga gjuha e gjallë e popullit. Pas pavarësisë u krijuan edhe disa kushte shoqërore-politike të tjera, edhe u ndërpre ndikimi aktiv i mëtejshëm i turqishtes dhe drejtpërdrejt i disa formave të jetës, të lidhura me të. Por, e para, kufizimi i përdorimit të turqizmeve nuk është thjesht punë e disa autorëve ose e puristëve. E dyta (që ka rëndësi të veçantë në planin stilistik), çdo qëndrim ndaj mjeteve gjuhësore është një vlerësim i tyre dhe çdo vlerësim u jep një ngjyrim të ri, i cili në fund të fundit *kthehet në ngjyrim stilistik dhe emocional-shprehës* (kur fjala a forma nuk del përfundimisht nga gjuha). Në përgjithësi mjetet gjuhësore nuk largohen nga gjuha përnjëherë e thjesht, por nëpërmjet një procesi rivlerësimi, i cili i shtyn në sfera të caktuara, pastaj në periferi, duke i ngjyrosur deri sa errësohen e nuk shihen më në gjuhë, ose mbeten një rezervë e dobishme pikërisht për rastet, kur gjuha ka nevojë ta bëjë ligjërimin e larmë, t'i japë një ngjyrë të caktuar.

29) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit...* f. 49.

30) A.V. Desnickaja, *O stilističeskoj funkcii turcizmov v albanskoj poezii*, në «Voprosi teorii i istorii jazyka», L. 1963.

31) Kështu p.sh. është quajtur fjalë asnjëse *nur* njësoj si *çift*, ose janë quajtur plotësisht të asimiluara fjalë si *karshi*, *javash*, *javash*, *qoshe*, *zaten* etj. dhe qortohet A. Xhuvani për përpjekjet e zëvendësimit të tyre. Midis *mik* e *mysafir* është parë një ndryshim stilistik, duke u harruar ndryshimi kuptimor, që e gjejmë qartë te «Fjalori i gjuhës shqipe». Kështu p.sh. *bisedë* (do të jetë lapsus trajta *bisedim* në artikull), *fat*, *dashuri* nuk janë të stilit të lartë përballë *muhabet*, *baft*, *sevda*, por janë fjalë stilistikisht neutrale, në krahasim me të cilat sinonimet turke kanë sot ngjyrim stilistik. Po ashtu, fjalët *asllan*, *kismet*, *selvi*, *sevda*, *baft* etj. nuk kanë qenë fjalë të «gjuhës poetike» për thjeshtligjërimin, siç shprehet autorja. Ato ishin thjesht fjalë të zakonshme, të cilat i përdorte edhe folklori e poezia; nuk ka ekzistuar ndonjë opozicion i tillë, që luan t'i përgjigjej në poezi e folklor *asllan*, ose në folklor e poezi të përdorej *kismet*, *baft*, *sevda*, *selvi* kurse jashtë tyre *fat*, *dashuri*, *qiparis*.

Kështu qëndrimi kundrejt huazimeve orientale si në gjuhën e shkruar edhe në ndërgjegjen e folësve të zakonshëm (të cilët shpesh edhe i perceptonin elementët e një gjuhe joindoeuropiane), çoi objektivisht në rënjen e një pjese të tyre dhe në shtresimin stilistik të një pjese më të madhe. Pasi qëndrimi ka qenë në përgjithësi negativ, është e pamundur të ringjallet kjo shtresë për funksione të reja e të pasura. Duke përmendur shembujt si *asllan*, *kismet*, *sevda*, *selvi* etj. theksojmë se ato as kanë qenë fjalë «poetike» dhe as ka se si të ringjallen për funksione të reja.

Edhe në stilin e veprimtarisë shoqërore-politike e të gazetarisë, ku vërehet sot një gjallërim i përdorimit të turqizmeve, ato dalin gjithnjë për karakterizimin negativ³². Është kjo arësyeja, që në veprat humoristike e të satirës së sotme turqizmat zënë një nga vendet kryesore për karakterizimin negativ dhe shembujt ka në çdo faqe të revistës «Hosteni». Po kështu ngjet në gjuhën e personazheve të veprave letrare.

Një çështje tjetër del nga analiza e një fjale si *ashik*. A. V. Desnickaja e quan fjalë të leksikut poetik popullor, krahas fjalëve si *selvi*, *asllan* etj. Po të ndiqej historia e fjalës, do të shihnim se që të fjalori i F. Rossit thuhet, që *ashik* përdorej për *dashnor* me kuptim të keq; në rast se mbajmë parasysh edhe qëndrimin ndaj dashurisë në rrethanat e një shoqërie patriarkale e konservatore, del e qartë ngjyra gjysmë ironike e liçencioze e kësaj fjale (sot edhe midis *dashnor* e *i dashur* ka dallime vlerësuese-ekspresive). Në këtë mënyrë, *historia e fjalës në gjuhën dhe në shoqërinë që e përdor lë gjurmët e veta në ngjyrimin e saj stilistik*. Që në çastin e huazimit të një fjale duhet parë, nëse vërtet gjuha kishte nevojë për një fjalë si emërtim të sendeve e nocioneve të reja, apo e ka marrë fjalën si një sinonim për të shprehur një qëndrim, një vlerësim të ri. Kjo kërkon një rishikim të punimeve të derisotme mbi huazimet e shqipes, sepse nuk është bërë një shtresim i tillë dhe prandaj tabloja e fjalëve të huaja në shqipen është me një ngjyrë të vetme, duke mos dalluar atë që ka hyrë për nevojat e vërteta të gjuhës, nga ajo që është marrë vetëm për kërkesa të veçanta ekspresive-stilistike.

Të marrim një shembull tjetër: fjala *krajl* jepet si e vjetëruar në kuptimin *mbret*³³. Në të vërtetë, që në fillim ajo ka patur kuptimin *mbret i huaj*, siç e gjejmë të dëshmuar p.sh. te fjalori i J. G. Hahn më 1854 dhe siç del kudo në folklor, prandaj ka pasur tjetër ngjyrim në krahasim me *regj* e *mbret*. Edhe sot fjala mund të përdoret për

32) Po sjellim vetëm disa shembuj për ilustrim. «Prapa çdo vizite të Titos, edhe kur kjo është shoqëruar me *çingitë* e *dajretë* e *haremeve*, kanë qëndruar qëllime të caktuara». (Zëri i popullit, 30.I.1968, f. 4); «Por më vonë, kur pa se mbasi mbolli erën, korri furtunën, ndërroi *havazin*». (Zëri i popullit, 17.V.1964, f. 2); «Sundonin në shumë parti si në *çifligjet* e tyre» (Zëri i popullit, 17.V.1964, f. 4); «*Jeniçerët* e tij në Kosovë janë lëshuar me tërbim» (Zëri i popullit, 5.IV.1967, f. 4); «Kapitalistët e rinj revizionistë nuk panë shumë *hair* nga gjoja ndihmat» (Zëri i popullit, 24.III.1968, f. 3); «Ka edhe nga ata, më në fund, që janë *raja* të përjetshëm» (Zëri i popullit, 15.III.1968, f. 4); «Deshën s'deshën, ata u mbyllën në sallat e Kremlinit me *jesirët* çekoslovakë» (Zëri i popullit, 14.VI.1969, f. 4), etj. etj.

33) A. V. Desnickaja, *Slavjanskije zaimstrovanija v allbanskom jazyke*, «V Mezhdunarodnyj sjezd slavistov». M. 1963. f. 2.

vlerësim stilistik në publicistikë dhe në thjeshtligjërim për humor³⁴. Huazime të tilla bashkëjetojnë me fjalët shqipe si sinonime stilistike.

Për sa u përket huazimeve sllave, greke dhe nga gjuhët e sotme europiane, në pikëpamje stilistike mungojnë trajtimet më vete; janë prekur kalimthi huazimet sllave nga A. V. Desnickaja dhe greqizmat nga A. Kostallari³⁵. Fati stilistik i huazimeve sidomos të sotme përcaktohet nga rruga e depërtimit, nga sfera ku gjejnë përdorim më të dendur, nga proceset e diferencimit sinonimik. Fjalët nga gjuhët neolatine p.sh. vërtet janë në pjesën më të madhe fjalë librare dhe shfrytëzohen në fragmentet me ton solemn, por nga ana tjetër kalojnë deri edhe në thjeshtligjërim³⁶.

Fusha e leksikut paraqet kështu një shumicë problemesh nga ana stilistike.

5. Më 1955 A. Kostallari konstatonte, që «Për problemin e stileve në gjuhën tonë nuk është bërë deri më sot asnjë studim qoftë edhe i pjesshëm»³⁷. Në «Parimet themelore...», d.m.th. 15 vjet më vonë, pohohet që «Studimi i problemeve të stileve funksionale në gjuhën shqipe dhe i mjeteve leksikore që lidhen me to ndodhet në fazën fillestare — deri më sot janë bërë vetëm disa vëzhgime në një plan tepër të përgjithshëm.»³⁸

Megjithatë, përveç trajtimit të çështjeve në lidhje me degët e ndryshme të gjuhësisë sonë, siç del dhe nga shqyrtimi që bëmë më lart, studjuesit kanë dhënë mendime edhe mbi stilistikën e stilet gjuhësore në përgjithësi. Një përfundim të tillë e gjejmë po atje te «Parimet themelore»: «Në vijat kryesore, në shqipen letrare janë përcaktuar tashmë stilet funksionale me tiparet e tyre më të përgjithshme. Sot mund të themi pa e tepëruar se gjuha jonë letrare është mjaft e pasur me stile të ndryshme të ligjiëratës. Këto stile, që janë formuar historikisht, sidomos në këtë shekullin e fundit, i japin gjuhës sonë një fuqi të madhe shprehëse»³⁹.

Zhvillimi i plotë i funksioneve shoqërore të shqipes në periudhën e ndërtimit socialist, gjë që pasqyron zhvillimin e vrullshëm të ekonomisë, shkencës, teknikës, kulturës, jetës shoqërore e politike të vendit tonë, jo vetëm i pasuroi stilet dhe bëri të mundur të pihen, por edhe krijoi kushtet për ndryshime cilësore në sistemin stilistik. Rezultati themelor, që mund të konstatohet sot, është kalimi nga periudha e përpunimit hap pas hapi të stileve të veçanta ose të veçorive të tyre, në krijimin e një *sistemi stilistik*.

34) P.sh. për vlerësim negativ në publicistikë: «Shikoni tani sadizmin e *krajlëve* «modernë»... E. Hoxha, Fjala në priftjen me rastin e 50-vjetorit të pavarësisë e 18-vjetorit të çlirimit në Vlorë, («Zëri i popullit», 30.XI.1962, f. 2); për humor në ligjërimin e thjeshtë «Po ju, *krajlja*, si u martuat? Pa na kallzoni njiherë, se s'kemi si e kalojmë kohën. «F. Cakaj, Lugina e nuseve, T. 1969, f. 41; ose në shprehjen për të qeshur: *krajl Shkodre*. Khs. për përdorimin edhe fjalën *king* në ligjërimin e thjeshtë, p.sh. «Hiqeshim si *kingat* më të mëdhenj të Tiranës» I. Kadare, Dasma, 1968, f. 153; «Profesioni *king*: për televizorë». po aty, f. 155.

35) A. Kostallari, *Parimet themelore...*, f. 78.

36) Khs. p.sh. përdorimin në thjeshtligjërim me nuanca të forta ekspresive të fjalëve huazime të reja si: *galera* — për radhët e fundit në klasë, flas me *spondë*-e them tërthorazi, në *disk* — zbatuar, s'ke *ide*, jam në *formë*, *reparti graso*, *kinkaleri*, — vogëlsira, *antikë* fare etj. Këtë fat ka sidomos terminologjia sportive dhe e lojrave të ndryshme etj.

37) A. Kostallari, *Në rrugën e hartimit...*, f. 48.

38) A. Kostallari, *Parimet themelore...*, f. 108.

39) A. Kostallari, *Parimet themelore...*, f. 109.

Detyra e parë e stilistikës mbetet pikërisht ta vështrojë këtë sistem stileshe në gjendjen e tij të sotme dhe të gjurmojë veçoritë e secilit stil brenda tij.

Përpunimi i sistemit stilistik të shqipes lidhet me etapën e formimit të gjuhës letrare dhe prandaj nuk mund të shkëputet prej historisë së saj. Tiparin gjuhësor më të rëndësishëm të gjuhës letrare e përbën norma. Karakteri i saj në gjuhën e sotme ka gjetur një trajtim të gjerë në disa punime të fundit⁴⁰. Për stilistikën ngulitja e normës ndikon në disa drejtime.

E para, norma letrare përcakton mjetet gjuhësore asnjëse, atë që është pjesa themelore, thelbi i gjuhës letrare të shkruar e të folur. Kështu bëhet e mundur që në një sfond asnjës të dallohen më shkoqur shtresat e mjeteve me ngjyrimë stilistike dhe të zënë vend opozicionet stilistike. Të sjellim edhe një shembull. Në «Fjalorin e gjuhës shqipe» fjala *takim* dhe fjala *pjekje* shpjegohen njëra me tjetrën, pa ndonjë dallim. Nga materialet e Kartotekës së leksikut të shqipes del se para luftës fjala *takim* kishte filluar të përdorej në kuptimin e *pjekjes*, ndërsa në gazetën «Bashkimi» më 1945 (17.VII) në një artikull me titull «*Takimi i të treve*», thuhet: «kanë dëshirë që *pjekja* e Potsdamit të dështojë», pra vërtet të dyja fjalët përdorshin paralelisht. Nga vitet 50 e këtej u ngulit si normë fjala *takim* në këtë kuptim, sot nuk mund të thuhet më «*pjekja e Potsdamit*» dhe prandaj fjala merr një ngjyrim stilistik. Ky është një rast i zakonshëm i diferencimit të sinonimeve, që shpie në shtresimin stilistik, ku mund të ketë një farë roli edhe homonimia e dy fjalëve *pjekje*.

Ndryshimin dhe përcaktimin e ngjyrimit stilistik të fjalëve krahas përpunimit të normës e gjejmë qartë në një fjali nga dy botimet e «Historisë së Skënderbeut» të F. Nolit. Ndërsa në botimin I (1921, f. 108) kishte «*rrëfëhuni burra si nga hera*», në botimin II (1950, f. 30), autori e ka ndrequr: «*tregohuni burra si gjithnjë*».

E dyta, vetë stilet gjithashtu përpunojnë normën e tyre, që i kundërvihet normës asnjëse dhe që e shfrytëzon atë në një mënyrë të caktuar, pra lind një lloj i ri norme: *stilistike*.

Kohën e shërbimit në radhët e ushtrisë p.sh. e quajmë *shërbim ushtarak* dhe themi: *kryej shërbimin ushtarak*, porse kjo është normë për stilin e punëve zyrtare. Në të folurit e përditshëm përdorim: *bëj ushtrinë*⁴¹ e kjo nuk gjen vend në ndonjë ligj ose dokument zyrtar; në të folurit e përditshëm nuk përdoret zakonisht formulimi zyrtar. Të ligjërimet bisedor janë përdorimet si: *kam mbaruar ekonomikun, mekaniken, elektrikun, mjekësinë* etj. në vend të: *kam mbaruar studimet në fakultetin e ekonomisë, në degën mekanike të fakultetit të inxhinjerisë* etj. Në një material zyrtar thuhet *caktoj një takim*, ndërsa në të folurit e zakonshëm *lë një takim* etj. Shkelja e normave stilistike zakonisht shkakton humor, siç e prekëm në pjesën për sintaksën, ose bën që të ndjehet diçka si mish i huaj në ligjërimin përkatës. Respektimi i këtyre normave ka rëndësi sidomos për ta bërë të folurit të larmë, me forcë shprehëse, për të shmangur shtampat e kallëpet në çdo fushë të veprimtarisë gjuhësore.

40) A. Kostallari, *Mbi tiparet kryesore të shqipes së sotme letrare*. «Shkencat shoqërore në shkollë», 1967, nr. 2; *Sur le traits principaux de l'albanais littéraire contemporain*, «Studia Albanica», 1966, nr. 2.

41) «Asht rritë Skënderi tashti, — thotë nanë Havaja. — Bani ushtrinë me nder, si burrat.» Nëndori, 1970, nr. 1, f. 122.

E treta, për shkakun objektiv, që gjuha u shërben të gjitha nevojave e sferave të jetës shoqërore, norma letrare nuk mund të zbatohet njësoj në të gjitha rastet. Ajo as përvetësohet njësoj menjëherë nga i gjithë kolektivi i folësve, as nuk i mbulon të gjitha funksionet njësoj. Prandaj norma na paraqitet me shkallë të ndryshme të ngulitjes, të përvetësimit dhe të funksionimit. Këto shkallë të ndryshme dalin në kundërvënien me normën e ngulitur, gjë që i kthen ato në kundërvënien stilistike.

Në këtë mënyrë, ne mendojmë se *shkalla e ngulitjes së normës letrare, e përvetësimit të saj dhe mënyra e funksionimit në një etapë të caktuar mund të shërbejë si kriter objektiv gjuhësor për dallimin e stileve të ligjërimit*. Këto shkallë të ndryshme mund t'i përfytyronim si të shtrira në dy boshte të kryqëzuara, i pari vertikal dhe i dyti horizontal.

I. Po ta vendosnim normën letrare si bosht vertikal në gjuhën e sotme shqipe, duke patur parasysh shkallën e ngulitjes e të përvetësimit të saj, do të na dilte afërsisht kjo prerje stilistike.

Mjetet asnjëse me normë të ngulitur (natyrisht, në shkallën e kristalizimit që është arritur) të gjuhës letrare të shkruar e të folur përbëjnë jo vetëm shumicën në numër, por edhe janë baza dhe indi i çdo ligjërimit me ngjyrim stilistik. Në këtë sfond gjatë prerjes shquhen:

A. Ligjërimit me normë më të ngurtë, me ndjeshmëri më të madhe ndaj lëkundjeve, me kufizime të mjetëve gjuhësore përkatëse në disa drejtime dhe me përdorimin e parapëlqyer të disa të tjerave, i cili në përgjithësi mund të quhej ligjërimit libror. Tiparet gjuhësore të këtij ligjërimit janë kryesisht ato, që nëpër punimet e gjuhëtarëve përcaktohen si tipare të gjuhës së shkruar. Në fakt, këto tipare përsëriten si në variantin e shkruar të këtij ligjërimit, edhe në variantin e folur, me ndryshimet përkatëse të mënyrës së komunikimit.

B. Ligjërimit bisedor, me lëkundje të normës, me një zbatim të saj më elastik, pa kufizime të ngurta në përdorimin e mjetëve dhe me pëlqimin e një shtrese të gjerë, që kërkohet nga kushtet, sfera dhe përmbajtja e komunikimit.

Tipare të këtij ligjërimit në gjendjen e sotme, të cilat për mendimin tonë meritojnë të theksohen veçan, janë këto dy. E para, ai po bëhet gjithashtu një *shtresë e vetme stilistike* e shqipes së sotme. E dyta, ndryshe nga të folurit letrar të mirëfilltë, ligjërimit bisedor ka ndikime krahinore përkatëse mbi mjetet e tija, sidomos në fushën e fonetikës dhe më pak në pjesët e tjera të strukturës. Ai ka jo variante të normës, por lëkundje të saja, mjete që dallohen si bisedore në krahasim me asnjëset, megjithatë këto nuk e pengojnë të jetë një ligjërimit, i cili ecën drejt shkarkimit pak nga pak nga ndikimet krahinore, për të përfunduar mirëfilli në një shtresë të gjuhës letrare, me veçori që i përcaktojnë kushtet e përdorimit, e sferës së komunikimit.

Po sjellim dy fraza tipike të këtij ligjërimit: «Plase duke bërë zbulime ti... Ja, nuk e sheh, mbetën të fshehtat t'i zbulosh ti!»⁴²; «Po edhe unë ama, kusur s'i kam lënë, veç mos më rëntë në tezë!»⁴³.

C. Fare pranë ligjërimit bisedor mund të dallohet edhe ligjërimit

42) «Nëndori», 1962, nr. 2, f. 128.

43) «Zëri i rinisë», 11.VI.1969, f. 1.

i thjeshtë ose «thjeshtligjërimit». Ky është si të thuash shkalla më e ulët, pasi krahas lëkundjeve të normës aty kemi edhe shkelje e shtrembërime të saja, kemi procese fermentimi dhe mjete me ngjyrim të theksuara emocionale e pak të rënda.

Në gjendjen e sotme na duket se ky ligjërimit lind në ndeshjen e të gjitha formave të gjuhës së sotme shqipe, ku vendin kryesor e zë ndeshja e dialekteve me gjuhën letrare. Ndërsa mbi ligjërimit bisedor mendojmë se norma ndikon si sistem i plotë dhe pak nga pak e shndërron të folurit e bartësve të tij duke lënë në të ndikimin vetëm të një dialekti a të folmeje (folësi bëhet i ndërgjegjshëm se nga duhet të orientohet), në thjeshtligjërimit norma nuk bëhet orientuesi i vetëm, drejt të cilit të ecej, duke ju përshtatur në diçka e duke ruajtur veçoritë e sferës së komunikimit, por ndërthuren disa ndikime. Në këtë kuptim ky është një brez fermentimi.

Këtu norma letrare nuk përvetësohet si sistem, por merren pjesë dhe elementë të saj, që për këtë arsye edhe shtrembërohen. Në këto rrethana lind edhe përzierja e dialekteve e të folmeve në ligjërimit. Kështu për mendimin tonë përzierja e dallon këtë si tipar kryesor nga ligjërimit bisedor, në veçanti përzierja me elementet letrare, librore dhe heterodialektore.

Kjo përzierje, karakteristike sidomos për folësit, që nuk kanë marrë arësimin e mesëm e të lartë sistematik dhe për qendrat industriale e bujqësore me përzierje të madhe faktike të popullsisë, për ushtrinë e aksionet, do të vazhdojë edhe një periudhë, duke ua lënë vendin ca nga ca në këtë proces fermentimi tipareve të tjera me karakteristike për të, që e bëjnë të jetë në periferi ose përtej gjuhës letrare⁴⁴.

Është e nevojshme të theksojmë, se me gjithë shtresimin e parqitur më lart, shtresat nuk janë të diferencuara prerazi, por janë në bashkëveprim e të ndërthurura, brendapërbrenda kanë ndarje më të vogla etj. Porse kjo do të thotë se mundësitë e brendshme stilistike të shqipes së sotme janë të gjera dhe të shumëngjyrshme.

II. Brenda kufijve të gjuhës letrare norma e ngulitur nuk mund t'i rrafshojë mjetet e përdorura në të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore. Secila sferë paraqet kërkesat e veta dhe përpunon një varg veçorish në zgjedhjen dhe organizimin e mjeteve, të cilat veçori pak nga pak bëhen të përhershme për sferën përkatëse, formojnë një farë nënsistemi mjetesh e mënyrash, që në gjuhësi është quajtur *stil funksional*.

Kështu një shtresim tjetër del në boshtin horizontal sipas sferave ku funksionon gjuha letrare dhe flasim për stilin e veprimtarisë shoqërore-politike e të gazetarisë, për stilin e veprimtarisë shtetërore (të administratës, ekonomisë, drejtësisë, diplomacisë etj.), për stilin e veprimtarisë shkencore (të studimeve në fushën e shkencës, artit, arësimit etj.) e të teknikës etj. Në këtë mënyrë ne e dallojmë stilin funksional nga kategori të tilla si ligjërimit. Kjo do të thotë p.sh. që elementë të stilit shkencor mund të përdoren edhe në bisedën e përditshme, dhe në thjeshtligjërimit, duke ndryshuar jo përkatësia funksionale e tyre, por shkalla e normativitetit.

44) Ja disa shembuj të këtij thjeshtligjërimit të mirëfilltë, që gjejmë përhapje të shpejtë në kushtet e fermentimit: «E o lab, si dole? E thithe maksimumin? (Zëri i rinisë, 11.VI.1969, f. 1); Sa çudi që bëhen». (Zëri i rinisë, 20.V.1961, f. 2); «Atë ditë isha pushim». (Hosteni, 10.IV.1968, f. 3). Mjetet e thjeshtligjërimit janë përdorur në gjuhën e Rudit nga I. Kadareja te «Dasma» për ta karakterizuar si personazh.

Edhe veçoritë e këtij shtresimi lidhen si me kushtet konkrete historike-shoqërore, ashtu dhe me formimin e gjuhës letrare. Edhe këto stile janë përvijuar të gërshetuar midis tyre, në afëri e marrëdhënje të ngushta. Sidoqoftë, secili prej tyre ka një farë bërthame të qëndrueshme, ka disa mjete leksikore e sintaktike të ngulitura, ka disa tipare, në bazë të të cilave ne jemi në gjendje të dallojmë p.sh. një tekst të publicistikës nga një shkencor; një tekst të veprimtarisë zyrtare nga një letrar etj. Prandaj sot mund të shtrohet si detyrë reale dhe e zbatueshme studimi i veçorive të stileve të shqipes letrare, ashtu siç bëhet edhe për gjuhët e tjera, megjithëse ka ende rrugë për të bërë në përsosjen e tyre të mëtejshme.

6. Pohimi, që në shqipen e sotme ka një sistem stilistik, qoftë dhe jo me tipare të përfunduara, shtron menjëherë pyetjen: si lindi ky sistem? Cilat janë burimet, që i dhanë gjuhës mjete të ndryshme, për t'i përdorur në stile të ndryshme? Kjo është *ana historike e çështjes*.

Në disa gjuhë të tjera sistemi stilistik është përpunuar mbi bazën e kundërvënjes së elementëve nga dy sisteme gjuhësore të ndryshme, qoftë midis gjuhës së gjallë dhe një gjuhe tjetër, qoftë midis gjendjes së vjetër dhe gjendjes së re të po asaj gjuhe⁴⁵.

Për gjuhën shqipe marrëdhënje me një kundërvënie të tillë nuk kanë patur vend. Kështu, në truallin tonë krahas shqipes janë përdorur gjuhë të tjera, p.sh. në mesjetë për M. Barletin gjuha e shkencës ishte latinishtja, për T. Kavaliotin ishte greqishtja, gjuhë e administratës dhe e gjyqeve për mjaft kohë ka qenë turqishtja. Megjithatë asnjë prej tyre nuk ka shërbyer si «ideali gjuhësor», si një sistem më i përpunuar, siç ka qenë latinishtja për italishten⁴⁶, gjuha e vjetër sllave kishëtare për rusishten, greqishtja e vjetër për të renë etj. Do të ishte shumë interesante të gjurmohet në këtë drejtim cili ka qenë «ideali gjuhësor» për autorët tanë më të mirë gjatë shekujve.

Mundësi për një farë amalgame stilistike ka patur për shqipen në gjuhën e bejtexhinjve. Ata mburreshin se e kishin ngritur lart dhe e kishin pasuruar shqipen⁴⁷ e në të vërtetë po përgatitnin truallin për një përzierje të tillë, ku orientalizmat do t'u përkiste vendi i stilit të lartë, poetik, forca shprehëse etj. Siç dihet, ky drejtim dështoi dhe bashkë me të edhe krijimi i një amalgame të tillë.

Edhe kundërvënia e gjendjes së vjetër me gjendjen e re nuk ka luajtur ndonjë rol të ndijshëm për shtresimin stilistik të shqipes. Letërsia deri në sh. XIX ruan mundësi për ta shfrytëzuar në drejtime të veçanta, pati përpjekje për këtë edhe nga rilindasit, por për shkak të kufizimeve të saj, nuk la gjurmë të posaçme.

Që këtej mund të nxjerrim përfundimin, se shtresimi stilistik në shqipen e sotme është rezultat i një procesi të brendshëm, që është

45) Për një varg gjuhësh ky problem është trajtuar hollësisht nga V.V. Vinogradov, *Problemy literaturnyh jazykov i zakonomernostej ih obrazovanija i razvitiija*, M. 1967; për rusishten në veçanti theksohet amalgame në të e dy sistemeve gjuhësore nga V.D. Levin, *Novyje knigi po istorii russkovo i ukrainskovo literaturnyh jazykov*, në «Voprosy jazykoznanija», 1959, nr. 3; A. Isaçenko, *K voprosu o periodizacii istorii russkovo jazyka*, në «Voprosy teorii i istorii jazyka», L. 1963.

46) V. Pisani, *In margine a due libri di storia della lingua italiana*, «Paideia», XVIII (1) 1963, f. 17 vij. shkruan për këtë: «Gjuha e folur... kishte shkallë të ndryshme përsosmërie sipas kulturës individuale, sidomos sipas shkallës së njohjes së latinishtes letrare, që në një farë mënyre ka përfaqësuar idealin gjuhësor deri në lindjen e letërsisë në gjuhën vulgare».

47) Shih: *Historia e letërsisë shqipe*, vëll I, T. 1959, f. 258.

zhvilluar kryesisht në etapën e lindjes e të formimit të gjuhës letrare kombëtare.

Rruga e kristalizimit të gjuhës letrare kombëtare nuk ka qenë e thjeshtë, goftë për rrethanat objektive, goftë për shkaqe subjektive⁴⁸, ajo na del e ndërlikuar dhe me zikzake. Në rast se do të shohim p.sh. gjithë prodhimin e shkruar gjatë Rilindjes, do të na dalë përpara një kaleidoskop i vërtetë. Ka aty shkrime thjesht dialektore, në dialekt të përpunuar, në gjuhë të folur të përpunuar (koinetë) ose të papërpunuar, në përzierje dialektore ose dhe në gjuhë artificiale etj. Ne mendojmë se kjo larmi krijoi kushtet objektive për bashkëveprimin dialektor në gjuhën e shkrimit, krahas bashkëveprimit të drejtpërdrejtë midis folësve⁴⁹.

Nga pikëpamja stilistike dëshirojmë të theksojmë dy anë në këtë proces.

E para, si e përmendëm për leksikon, çdo qëndrim ndaj mjeteve gjuhësore është një vlerësim i tyre, i cili shndërrohet në ngjyrim stilistik dhe emocional-shprehës. Në prizmin e gjuhës së vetme letrare kombëtare, kjo do të thotë që hap pas hapi me ngulitjen e shumicës së mjeteve si pjesë përbërëse e saj, mjetet e tjera që ruanin ndonjë vlerë, nuk flakeshin tej, por merrnin një funksion tjetër. Pra ndeshja e varianteve të ndryshme të gjuhës që kërkonin të zinin vendin e letrares dhe kapërcimi nga një etapë në tjetrën nuk është zgjidhur thjesht me fitoren e një varianti ose me mohimin e një etape. Kjo ndeshje në disa raste është shndërruar në një kundërvënie stilistike të mjeteve. Kristalizimi i normës letrare në këtë mënyrë jo vetëm nuk e ka ngushtuar e kufizuar gjuhën, jo vetëm nuk ka lindur rrezikun e «shuarjes» ose të «zhdukjes» së mjeteve, pasurive, vlerave të krijuara historikisht në truallin e shqipes, por përkundrazi, ka bërë një rivlerësim të çdo gjëje me vlerë, e ka ndriçuar me tjetër dritë, u ka dhënë role të tjera e u ka çelur mundësi të reja shprehëse mjeteve të shqipes. Edhe sot lëkundjet që ende vazhdojnë në normë në nivelet e ndryshme ose diferencat midis normës e jonormës ruajnë mundësinë për t'u shndërruar në disa raste në diferenca me ngjyrimet stilistike.

Ky është burimi kryesor i stileve të shqipes. Është e vërtetë gjithashtu, që stilet e gjuhës së shkruar kanë pësuar ndikim të ndjeshëm nga jashtë, por kjo ka qenë një fushë e hapët nga të gjitha drejtimet dhe në fund të fundit fati i çdo ndikimi është varur nga bluarja dhe shoshitja, që i ka bërë shqipja për nevojat e veta.

Rezultati më i rëndësishëm i asaj gjendjeje, që nga vështrimi i sotëm na duket kaleidoskopike, është zbulimi i mundësive të shqipes. Rilindja filloi zbulimin e shtresave të thella të gjuhës, kërkoi në skajet e largëta dhe në histori, zgjoi mjetet e fjetura, krijoi, përpunoi e përshtati. Ajo nuk e çoi dot deri në fund këtë punë për shkak të rrethanave të njohura historike e shoqërore dhe i takoi etapës së ndër-

48) Shih shën. 40.

49) L. Gurakuqi e dëshmon qartë këtë bashkëveprim: «E njimen janë më shumë se tetë vjetë, qi unë po përpiqem me toskërishte e qe një kohë, kuur pata marr kaq shije e dashuni n'te, saa ishe gati tuej u kapë krejt mas saj... Tuej kuvendue (toskët) me mue e tuej paa se un ishe gegë, ata do t'munoheshin me i hanger fjalët e me e nruë shqyptimin e vet për me iu afritë folmes seme.» *Vargërimi n'gjuhë shqype*, 1906, f. 78. Për shkrimet mjafton të përmendim një përmbledhje si *Libëri i përvjetshëm Shqipëtarit, 1911, botuar prej zyrës së fletë «Shqipëtarit» në Stamboll;* ose letrat e A. Çajupit dhe të F. Shirokës në «Çajupi-Vepra», T. 1957, f. 336-341.

timit socialist që ta kurorëzonte, porse që në Rilindje u krijua premisa themelore për zhvillimin stilistik: *mundësia e zgjedhjes*, mundësia e lindjes së kundërvënieve, e sinonimisë stilistike në masë të gjerë.

E dyta, në çështjen e ngulitjes së gjuhës letrare ana më e vështirë kanë qenë marrëdhëniet e dialekteve, e varianteve dialektore.

Analiza e rrugës së përpunimit të stileve sipas sferave në gjuhën letrare do të na tregonte se ato kanë ecur përpara, pavarësisht nga ngjyrimet dialektore. Kështu p.sh. përpunimi i stilit zyrtar nuk është përcaktuar nga vendimet për të zbatuar këtë ose atë dialekt, nga prania ose mungesa e rotacizmit etj. Në gjendjen e sotme kjo është fare e qartë. Të marrim si shembull një citat nga «Buletini shkencor i Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës» (1966, nr. 4, f. 20): «Por ndërsa kanga jonë mburr besnikinë e grues, kanga rumune dënon randë pabesinë e saj. Ngjashmëni ma tepër në disa motive kanë kanga arbëreshe Kostandini i Vogëli th me kangën rumune Moshegul.. dhe pikërisht në thirrjen që i ban Mbreti dhandrrit të ri për të shërbye n'ushtri nandë vjet e nandë dit...» Në rast se do ta kthenim citatin: «Por ndërsa kënga jonë mburr besnikërinë e gruas, kënga rumune dënon rëndë...» atëhere do të bëhej e qartë se për stilistikën këtu nuk ka vend. Natyrisht, disa dhjetra vjet më parë gjendja nuk ishte kaq e thjeshtë, ka patur prirje edhe për diferencime, por përsëri drejtimi themelor mbetej përpunimi objektiv i stilit pavarësisht nga veshja dialektore. Le të sjellim një citat nga «Fletorja zyrtare» e vitit 1927: «Çdo mami komunale detyrohet të mbajë një regjistër të pjelljeve, në të cilat ajo asht gjindun gati, tue bërë në këto shënime e duhuna për çdo pjellje.» Këtu ka një përzjerje dialektore, por është e qartë që kemi të bëjmë me një fragment nga stili zyrtar. Ndryshimi për ta sjellur në stilin e sotëm zyrtar do të kërkonte zëvendësimin e *pjellje* me *lindje*, pasi sot *pjellje* për njerëzit është e ligjërimit bisedor me ngarkesë emocionale, gjithashtu *asht gjindun gati* mund të jepej: *ka marrë pjesë, ka dhënë ndihmën*. Këto «ndreqje» janë treguesit e ngulitjes së mjeteve të stilit.

Pra studimi i historisë së formimit e të kristalizimit të gjuhës letrare kombëtare, duke na treguar rrugën e varianteve të ndryshme letrare, marrëdhëniet e tyre me gjuhën e gjallë, ndërlikimet e zikzaket etj. ndihmon njëkohësisht për të sqaruar përpunimin e stileve të saj. Me këtë sigurohet edhe kuptimi i stilit si nocion historik, në zhvillimin dhe ndryshimin e vet.

* * *

Përfundimet mbi sistemin e sotëm stilistik të shqipes dhe mbi diferencimin e stileve të caktuara, nxjerrin një varg detyrash, që presin zgjidhje në këtë fushë.

Para së gjithash janë për t'u studjuar stilet një për një si nënsisteme, si ligjërimi me kërkesa të caktuara, pra duke u nisur nga kërkesat e përmbajtjes së veprimtarisë në këtë ose atë sferë, dhe jo vetëm nga përshkrimi i mjeteve karakteristike. Rëndësi të veçantë merr trajtimi i sinonimisë stilistike, i mundësive të shprehjes së po asaj përmbajtjeje me mjete të ndryshme sipas kërkesave të secilit stil. Nxjerrja në dritë e opozicioneve stilistike sqaron edhe lidhjet e diferencat midis tyre.

Studimi i veprave konkrete përfaqësuese të stilit do të jepte një

material ilustrativ të pasur, pa të cilin punimet stilistike mbeten ske-matike.

Përshkrimi i veçorive të sotme të stileve të shqipes do të lehtë-sonte edhe ndjekjen e rrugës së krijimit të tyre. Në këtë plan prani-mi i lidhjeve të ngushta të gjuhës së gjallë të folur me gjuhën e shkru-ar përbën një parim themelor për të kuptuar marrëdhënjet e ngushta të të gjitha nënsistemeve të shqipes, pra për të kuptuar se përvijimi i stileve nuk është një pjesëtim i gjuhës, por një degëzim i saj për ta bërë më të aftë që t'u përgjigjet kërkesave të gjithanshme të kohës sonë.

Pas një zhvillimi shumëshekullor në gojën e popullit, nëpër dialekte ose në pendën e lëvruesve, sot gjuha shqipe na del e pasur dhe e për-punuar, me larmi stilesh e mundësi zhvillimi dhe përsosjeje të më-tejshme. Studjuesve u mbetet detyrë që ta thellojnë më tej trajtimin e kësaj ane, krahas strukturës leksiko-gramatikore të shqipes, duke patur parasysh sidomos lidhjen e saj të ngushtë me funksionet e gju-hës në jetën e shoqërisë.

R é s u m é

A PROPOS DE L'ETUDE DES PARTICULARITES STYLISTIQUES DE L'ALBANAIS

L'élargissement des fonctions sociales de l'albanais, notamment écrit, et l'épanouissement de la littérature artistique de la deuxième partie du XIX^e siècle ont soulevé toute une suite de questions de la langue littéraire albanaise, dont au nombre aussi celles de la stylistique.

Antérieurement à la libération il y a eu plusieurs travaux sur la stylistique de l'albanais, à commencer par les notes de L. Gurakuqi, les productions d'A. Zanoni, J. Rrota, A. Xhuvani et K. Cipo, mais ceux-ci se rapportaient plutôt à la stylistique de la littérature artistique. Le résultat le plus important dans ce domaine après la libération est la formation de la stylistique linguistique en tant que branche à part, qui s'est assignée des tâches distinctes de la stylistique littéraire.

Quoiqu'on n'ait pas encore des productions particulières consacrées à la stylistique linguistique, toujours est-il que dans les différents travaux sur la langue albanaise contemporaine on trouve plusieurs observations et même des traitements qui ont mis au clair les particularités stylistiques des moyens de l'albanais en phonétique, morphologie, syntaxe, lexicologie et formation des mots. Dans l'exposé ci-contre est donné un tableau récapitulatif de ces observations, en indiquant les principales directions de l'étude et en discutant sur plusieurs qui surgissent pendant cette étude.

Afin de fixer la stratification stylistique de l'albanais contemporain on a considéré comme un critère de base la norme de la langue littéraire et on a discerné deux directions principales de cette stratification.

Premièrement d'après le degré de fixation, d'assimilation et de fonctionnement de la norme littéraire on peut distinguer en albanais

d'aujourd'hui: la langue écrite, laquelle fait état d'un usage rigoureux de la norme, est sensible à tout écart et préfère quelques moyens donnés, qui rendent à l'évidence la nuance des livres. C'est la langue écrite, laquelle, pour une suite de traits, se fait distinguer du langage vivant, parlé. 2. La langue familière est une sphère où la norme résulte par une application élastique, où les conditions de communication permettent différents écarts et exigent l'usage d'une suite de moyens, lesquels ne pénètrent pas toujours dans la langue écrite. Une caractéristique propre à ce langage en albanais contemporain est la conservation de l'influence du dialecte ou du parler auquel appartient le sujet-parlant. Malgré ce genre d'influence, le parler familier est devenu actuellement, au même titre, une couche stylistique unique de l'albanais. 3. La langue populaire est, en albanais actuel, une couche de ferments, où se heurtent toutes les formes linguistiques et notamment la langue littéraire avec les dialectes. Sa caractéristique n'est point une norme donnée, mais la violation de la norme littéraire, jusqu'à sa falsification.

Ces langages se font distinguer dans le fond des moyens neutres de la langue, des moyens en concordance régulière avec la norme littéraire écrite et parlée, qui constituent la partie fondamentale la plus importante et la plus abondante de l'albanais d'aujourd'hui.

Deuxièmement, la norme n'agit point de la même façon aussi dans la sphère de la langue littéraire. Chacune des sphères présente des demandes données envers la langue et préfère un nombre de moyens qui forment un sous-système. En raison de la dépendance de la fonction de la langue dans chacune de ces sphères, ce sous-système a été appelé style fonctionnel. En albanais contemporain on distingue, p. ex., le style de l'activité socio-politique et de la publicistique, le style de l'activité d'Etat (administration, économie, justice, diplomatie, etc.), le style de l'activité scientifique (des études dans les domaines de la science, des arts, de l'enseignement, etc.), de la technique de production, de la littérature artistique.

Ainsi on peut admettre qu'en albanais contemporain il y a un système stylistique. Les styles ne sont pas isolés, naturellement, par un fossé, ils ont des rapports et s'enchevêtrent intimement, mais on peut poser comme une tâche réelle l'étude du noyau stable et des moyens les plus caractéristiques à chacun des styles.

L'histoire de la langue littéraire albanaise nous montre que les particularités stylistiques de ses moyens n'ont pas pris naissance sur l'enchevêtrement des différents systèmes, comme il est arrivé dans d'autres langues, comme p.ex. dans le russe, le grec, etc. C'est pourquoi ces particularités ont pris naissance à partir d'une stratification intérieure des moyens, de sorte que aussi les influences étrangères ont été moulées et traitées d'une façon originale dans l'albanais d'aujourd'hui.

Une problème intéressant présente le rapport des styles fonctionnels avec les variantes littéraires sur des bases dialectales.

La délimitation des styles de l'albanais atteste d'un niveau de traitement et d'enrichissement de l'albanais, de possibilités variables dans l'extériorisation des opinions avec fermeté, agileté, maîtrise, en correspondant dûment aux exigences de toute sorte de notre époque, à un temps où les fonctions sociales de l'albanais sont aussi nombreuses.